



REPUBLIKA E SHQIPËRSIË
Kolegji Universitar "Pavarësia Vlorë"
Senati Akademik

STRATEGJIA E KËRKIMIT SHKENCOR
2017 - 2022

(Miratuar me Vendim nr. 31, datë 28.06.2017 të Senatit Akademik)

Vlorë, Qershor 2017



Strategjia e Kërkimit Shkencor është një dokument që pasqyron planifikimin 5 vjeçar të punës dhe të zhvillimit të Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë" (në vijim KUPV). Kjo strategji përcakton objektivat kryesore dhe sfidat në vitet në vazhdim, mënyrat, mjetet dhe masat konkrete për realizimin e tyre.

Ky dokument përcakton jo vetëm parashikimet për arritjet e IAL deri në fund të afatit 5-vjeçar, por tregon se cilat do të jenë hapat që duhet të ndjekim për të arritur suksesin tonë dhe të studentëve tanë.

Në këtë Strategji pasqyrohen:

- Misioni i IAL për kërkimin shkencor;
- Fusha e veprimtarisë kërkimore shkencore (baze dhe të zbatuar) për çdo program studimi;
- Komunikimi me AKKSHI mbi identifikimin e fushave prioritare të kërkimit shkencor, mbi projektet në nivel kombëtar, për informacion dhe koordinim të aplikimeve në projekte ndërkombëtare, për fonde për projektet e studimeve në doktoratë;
- Komunikimi me zyrën e projekteve në KUPV mbi aplikime në projekte me nivel kombëtar;
- Mënyra dhe mundësi të tjera të fitimit të grandeve për kërkim shkencor;
- Botime në periodike shkencore universitare dhe proceedings;
- Organizimi i Konferencave Kombëtare / Ndërkombëtare në mënyrë periodike 1 deri në 2, në çdo vit;
- Përfshirja e studenteve cilësorë në aktivitetet/punë kërkimore shkencore;
- Bashkëpunimi për aplikime projektesh në nivel rajonal, kombëtar dhe më gjerë;
- Mënyra e menaxhimit të fondeve të KUPV për kërkim shkencor;
- Përcaktimi i normuar (i matshëm) i stafit akademik me punë të pavarur kërkimore dhe shkencore;
- Përfshirja në faqen WEB të KUPV të aktivitetit shkencor të çdo njësie bazë (konferenca, simpoziume, workshope etj.)
- Plan veprimi (ACTION Plan) për çdo Qendër Kërkimore;

I. Misioni, përgjegjësitë dhe detyrat

Kolegjin Universitar "Pavarësia Vlorë" në drejtim të kërkimit shkencor ka për **Mision**:

Të ofrojë kërkime, studime shkencore e botime cilësore sipas fushave të studimit që mbulon çdo fakultet, si dhe të menaxhojë veprimtarinë kërkimore e shkencore në përputhje me nevojat, vizionin dhe prioritetet strategjike të zhvillimit të Institucionit.

Në funksion të përmbushjes së këtij misioni, KUPV ka këto përgjegjësi e detyra:



- Kryen kërkime shkencore dhe studime në fushën e drejtësisë, ekonomisë, shkencave politike, informatikës dhe arkitekturës, në përputhje me vizionin dhe prioritetet strategjike të zhvillimit të Institucionit.
- Ofron botime në fusha të ndryshme sipas standardeve të cilësisë dhe të etikës akademike si: revista shkencore e qendrës, tekstet, broshurat, guidat, si dhe produkte të tjera informuese të shfrytëzueshme si për komunitetin shkencor, ashtu dhe për një audiencë më të gjerë.
- Menaxhon kërkimin shkencor në KUPV dhe mbështet personelin akademik në aktivitetet e tyre kërkimore si dhe mbështet personelin akademik dhe studentët e KUPV lidhur me hulumtimet dhe metodologjinë e kërkimit shkencor.
- Zhvillon një politikë të gjerë bashkëpunimi në fushën e kërkimit shkencor me institucionet e tjera kërkimore të arsimit të lartë dhe institucionet dhe agjencitë e tjera të sigurisë.
- Shpërndan rezultatet studimore si dhe informon publikun duke përdorur strategji dhe teknika të ndryshme si: publikime, publikime online, promovime studimore, diskutime në grupe specialistësh, seminare, simpoziume, konferenca, panele akademike etj.
- Organizon konferenca shkencore vendore, rajonale dhe ndërkombëtare në bashkëpunim me struktura e institucione të tjera kërkimore në vend dhe jashtë tij.
- Organizon veprimtari të tjera hulumtuese-zhvillimore-shkencore në fushat që mbulohen me programet studimore në fakultetet e KUPV.
- Kontribuon në mësimdhënie, dhe mbështet fakultetet e KUPV në programet dhe kurrikulat sipas nevojës.

Për të realizuar këtë mision dhe këto detyra, KUPV harton programe për zhvillimin e veprimtarisë së saj vjetore, të cilat më pas zbërthehen dhe shndërohen pas miratimit në program pune përgjatë vitit akademik.

II. Baza ku mbështetet programi:

- Ligji nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë";
- Statuti i Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë";
- Strategjia e SHPAL "Pavarësia" Vlorë për periudhën 2015 – 2020;

III. Prioritetet dhe objektivat:

- a. Vënia në efikasitet të plotë, krijimi i infrastrukturës për punë kërkimore-shkencore dhe për ofrimin e shërbimeve;
- b. Zhvillimi dhe integrimi i kapaciteteve njerëzore për veprimtarinë kërkimore-shkencore në KUPV;
- c. Ndërtimi i një kulture kërkimore në respekt të plotë të parimit të ndershmërisë, nivelit të lartë shkencor, kompetencës, kontekstualitetit dhe integritetit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të fushës.



- d. Bashkëpunimi me sektorin publik dhe privat në realizimin e projekteve kërkimore që janë në funksion të përmbushjes së misionit të KUPV;
- e. Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore;
- f. Rritja e kapaciteteve të mësimdhënies dhe përkthimit në gjuhë angleze.

IV. Masat, detyrat dhe aktivitetet që do të organizohen për realizimin çdo prioriteti dhe objektivi:

KUPV synon arritjen e një niveli të lartë kërkimi dhe shpërndarjen e rezultateve të saj, në mbështetje të Institucionit dhe përmbushjes së misionit ligjor të tij, duke ndërtuar një kulturë kërkimore në respekt të parimit të ndershmërisë në kërkim, nivelit të lartë shkencor, kompetence, kontekstualitet dhe integritet në përputhje me kornizën ligjore dhe etike të fushës në të cilën vepron.

Për të siguruar një performancë të kënaqshme në të gjitha nivelet, KUPV do të realizojë prioritetet, objektivat dhe aktivitetet si më poshtë:

Nr	Prioritetet / Objektivat	Afati	Struktura përgjegjëse	Komente
1	Prioriteti A: Vënia në eficiencë të plotë, krijimi i infrastrukturës për punë kërkimore-shkencore dhe për ofrimin e shërbimeve.			
	Objektivi 1. Hartimi dhe miratimi i Paketës së re normative të rregullimit të veprimtarisë së KUPV	Brenda vitit akademik 2017-2018	Grupet e punës	
	1.1 Rishikime të draft rregullores dhe paraqitjes për miratim të Rregullores së Qendrave Kërkimore Shkencore.		Grup pune	
	Objektivi 2. Realizimi i detyrave kryesore në fushën e kërkimit, studimeve dhe botimeve			
	2.1 Përgatitja për botim e numrave periodikë të Revistës "Pavarësia", një botim çdo gjashte muaj për të mundësuar dy numra periodikë të revistës brenda periudhës së një viti.	Çdo vit	Bordi Editorial	
	2.2 Përpunim, përkthim dhe hedhje të materialeve që pasqyrojnë aktivitetin e KUPV në webfaqen online.			
	2.3 Angazhimi në mësimdhënie në programet e fakulteteve të KUPV.			



	2.4 Organizimi i një trajnimit nga QKSHH si pjesë e programit të trajnimeve në KUPV me temë: "Dita ndërkombëtare e mjedisit".	Qershor (çdo vit)	QKSHH & IT QKSHH	
Objektivi 3. Krijimi i infrastrukturës për punë kërkimore shkencore dhe ofrimin e shërbimeve				
	1. Kërkimi dhe listimi i disa librarive online/webfaqe me interes kërkimor e shkencor të fushës, paraqitja për aprovim dhe mbështetje me financë për abonime.	Në fillim të çdo viti akademik	Qendrat Kërkimore. & Biblioteka.	
Prioriteti B. Zhvillimi dhe integrimi i kapaciteteve njerëzore për veprimtarinë kërkimore shkencore në KUPV.				
<p>Në KUPV ka munguar një sistem stimulues i avancimit të personelit bazuar në rezultatet nga veprimtaria kërkimore-shkencore dhe zhvillimore. Qendrat e Kërkimit Shkencor do të angazhohen për stimulimin e kuadrit që merret aktivisht me veprimtari të tillë në të gjitha disiplinat. Me qëllim shfrytëzimit racional të personelit akademik dhe infrastrukturës ekzistuese, QKSH do të ndjekin një politikë të bashkëpunimit dhe përfshirjes në veprimtari kërkimore hulumtuese e zhvillimore brenda dhe në mes të njësive akademike të KUPV.</p> <p>QKSH do të nxisin angazhimin e studiuesve të rinj nga radhët e studentëve të KUPV, ndihmesën dhe përkrahjen e atyre studentëve që janë të përkushtuar për të kontribuar në këtë lloj veprimtarie.</p> <p>QKSH do nxisë dhe inkurajojë edhe angazhimin e studiuesve të tjerë që nuk janë pjesë KUPV, që mund të jenë nga kontingjente të ish-studentëve, të cilët janë të angazhuar në veprimtari studimore e kërkimore në jetën e tyre akademike individuale apo në kuadër institutesh kërkimore, qendra kërkimore e shkencore jo publike.</p>				
Fusha I- Përmirësimin e kapaciteteve njerëzore të vetë QKSH, avancimin akademik të personelit ekzistues dhe rekrutim personeli të ri me sfond akademik.				
Objektivi 1: Avancimi në karrierën akademike të personelit ekzistues				
	1.1 Pjesëmarrje individuale në konferenca, seminare, wokshope organizuar nga qendrat kërkimore, universitete homologe brenda dhe jashtë vendit. 1.2 Ndjekje e programeve të doktoraturës nga personel akademik me master shkencor. 1.3 Kontribut me artikuj shkencorë në Revistën "Pavarësia" dhe organe shkencore të tjera brenda dhe jashtë vendit. 1.4 Marrja pjesë me kumtesa në konferenca shkencore.	Çdo vit	Stafi akademik	
Objektivi 2 : Rritja e vizibiliteti të punës individuale akademike në funksion të kontributit për vizibilitetin e QKSH.				



<p>2.1. Botime online në webfaqen e KUPV të aktiviteteve të stafit akademik.</p> <p>2.2. Punime individuale në bashkëpunim me autorë të tjerë të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>2.3. Botime të kumtesave të mbajtura në konferenca të ndryshme si pjesëmarrje individuale.</p> <p>2.4. Pasqyrim në webfaqe të strategjive zhvillimore të KUPV dhe kërkimit shkencor në shqip dhe gjuhën angleze.</p>	Çdo vit	Stafi akademik	
Fusha II. Nxitjen e një qasjeje ndërdisiplinore në veprimtarinë kërkimore shkencore			
Objektivi 1. Përfshirjen e kapaciteteve nga radhët e stafit akademik mësimdhënës, studentëve të KUPV në veprimtarinë kërkimore-shkencore.			
<p>1.1 Bashkëpunimi me departamentet e Fakultetet në KUPV.</p> <p>1.2 Identifikimi i studiuësve potenciale.</p> <p>1.3 Bashkëpunimi me stafin akademik të fakulteteve për identifikimin e studentëve me potencial studimor e kërkimor.</p> <p>1.4 Pasqyrimi në një bazë të dhënash i begraundit shkencor për shfrytëzim ngritje grupesh studimore e kërkimore sipas specifikave.</p>	Çdo vit akademik	Stafi akademik	
Objektivi 2. Përfshirjen e studiuësve ekzistues dhe të rinj në radhët e strukturave të KUPV në veprimtari hulumtuese, studimore e kërkimore-shkencore			
<p>2.1 Identifikimi i studiuësve potencialë në radhët e studentëve.</p> <p>2.2 Angazhimi i tyre për menaxhim plotësimi pyetësorësh, anketash, grumbullim të dhënash statistikore etj.</p>	Çdo vit akademik	Stafi akademik	
Objektivi 3. Zhvillimi i kriterëve për stimulim material dhe detyrime kontraktuale për kontribut në veprimtari shkencore			
<p>1.1 Konsultimi me modele.</p> <p>1.2 Hartimi i draft propozimeve për stimulim të stafit akademik të përfshirë në veprimtari kërkimore shkencore.</p>	Çdo vit akademik	Stafi akademik	
Prioriteti C: Ndërtimi i një kulture pune në respekt të plotë të parimit të ndershmërisë, lirisë akademike, pronësisë intelektuale, nivelit të lartë shkencor, kompetencës, kontekstualitetit dhe integritetit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të fushës.			
<p>QKSH do të angazhohet për të garantuar një mjedis pune të sigurt në të cilin të zhvillohet veprimtaria kërkimore, me politika të qarta për mbledhjen e materialeve, ruajtjen e të dhënave dhe rezultateve të veprimtarisë kërkimore, si edhe të drejtën e konsultimit të tyre nga studiuësit e interesuar. Politikat institucionale do hartohen në përputhje me praktikatat pozitive të disiplinës përkatëse, në të cilën zhvillohet veprimtaria kërkimore dhe me legjislacionin në fuqi. Të dhënat e kërkimit do të digjitalizohen dhe ruhen në</p>			



bazën elektronike të dhënave të qendrës. Për raste të veçanta, periudha për ruajtjen e të dhënave do të përcaktohet nga specifika e fushës së kërkimit.			
Objektivi 1. Ndjekja e një politikë të vendosur anti-plagjiaturë dhe respekt pronësie intelektuale.			
1.1 Mbështetja e Këshillit të Etikës ngritur në KUPV. 1.2 Bashkëpunim dhe mbështetja e Bordit Editorial të Revistës 'Pavarësia'. 1.3 Artikujt që paraqiten si kontribut për botim në numrat e Revistës "Pavarësia" i nënshtrohen redaktimi shkencor dhe teknikave anti-plagjiaturë. 1.4 Raportimi i veprimeve të ndëshkueshme në kërkimin shkencor.	Çdo vit akademik	Stafi akademik	
Objektivi 2 Transparenca e organizmave financuese të veprimtarisë kërkimore dhe mënyrën se si janë fituar e menaxhuar projektet kërkimore nga kërkuesit apo grupet kërkimore.			
2.1 Transparenca për çdo pagese kontributi në studime nga studiues studente apo punonjës të strukturave akademike të përfshirë në një grup studimor. 2.2 Transparenca e llogarive të pagesave ndaj Bordit Editorial dhe artikullshkruesve të Revistës, pavarësisht se janë objekt i punës së Sektorit të logjistikes dhe financës.	Çdo vit akademik	Stafi akademik	
Prioriteti D. Bashkëpunimi me sektorin publik dhe privat në realizimin e projekteve kërkimore që janë në funksion të përmbushjes së misionit të KUPV.			
Veprimtaria kërkimore-shkencore nuk mund të shikohet në mënyrë të izoluar. KUPV ka mundësitë financiare të kufizuara për të financuar kërkime specifike. Në këtë kuadër, QKSH janë të përkushtuara që të forcojnë dhe intensifikojnë bashkëpunimin dhe partneritetin në kërkime shkencore me palët të tjera me interes, përfshirë sektorin publik dhe atë privat. Një partneritet i tillë do të avancojë dukshëm pozitën e KUPV në vend, duke ndikuar zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe politik-bërjen në mënyre konstruktive.			
Objektivi 1: Hapja për bashkëpunim me sektorin publik dhe privat për projekte kërkimore shkencore në interes të KUPV.			
1.1. Gjetja e partnerëve në sektorin publik dhe privat, të interesuar për financimin e kërkimit shkencor dhe hartimi me ta i projekteve të përbashkëta kërkimore shkencore, konferenca kombëtare apo ndërkombëtare etj.	Çdo vit akademik	Stafi akademik	
Prioriteti E: Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë kërkimore shkencore			
Objektivi 1. Lidhjen e partneriteteve strategjike me institucione akademike, qendra kërkimore, institute studimore me reputacion ndërkombëtar.			



1.1. Bashkëpunim me qendra kërkimore shkencore të institucioneve akademike brenda dhe jashtë vendit me të cilat KUPV ka marrëveshje bashkëpunimi dypalëshe.	Çdo vit akademik	Stafi akademik	
Objektivi 2. Bashkëpunim me homologë e partner për të bashkëfinancuar zbatimin e projekteve ndërkombëtare			
2.1. Bashkëpunim me qendra kërkimore shkencore të universiteteve/ kolegjeve universitare partnere.	Çdo vit akademik	Stafi akademik Qendrat Kërkimore Shkencore	
Objektivi 3. Shpërndarje, publikime në shqip dhe gjuhë të huaj, sipas standardeve ndërkombëtare të botimeve <i>print</i> dhe <i>online</i> për një akses sa më të gjerë në komunitetin dhe audiencën kërkimore shkencore			
3.1 Botim i Revistës "Pavarësia" në gjuhën angleze. 3.2 Botim i kumtesave të konferencës shkencore në gjuhën angleze.	Çdo vit akademik	Bordi Editorial Qendrat Kërkimore Shkencore	

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Luan GJONÇAJ